

Dasma e Qengjit

MANUALI I SEMINARIT PËR DHIATËN E RE

- Cilat janë disa arsye pse familjet shpesh festojnë nëpër dasma?

Gjoni e përdori shëmbëlltyrën e një dasme për të na dhënë mësim rreth ditëve të fundit. Dasma për të cilën ai shkroi, është simbolikë për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit.

Bëj një vizatim të thjeshtë të një nuseje dhe një dhëndri dhe shkruaj atë që mëson rreth secilit ndërkohë që studion.

Lexo te Zbulesa 19:7–9 për të parë se si na inkurajon Zoti të ndihemi rreth kësaj dasme. Nusja në këto vargje është simbolikë për anëtarët e Kishës së Zotit që po e përgatitin veten për rikthimin e Krishtit.

- Sipas vargut 8, si duhet të përgatitemi për këtë dasmë? Çfarë kuptimi mund të ketë kjo për ty?
- Në çfarë mënyrash marrëdhënia martesore është një simbol i përshtatshëm i marrëdhënies sonë besëlidhëse me Jezu Krishtin?
- Si mund të jetë kthimi i Shpëtimtarit një kohë gëzimi për ty?

Lexo shkrimet e shenjta në vijim dhe mendo rreth asaj që mund të bësh për t'u përgatitur për kohën kur Jezu Krishti të vijë përsëri. Mund të duash ta shenjosh atë që gjën në shkrimet e tua të shenjta, ose të shkruash rreth saj në ditarin tënd.

Zbulesa 7:13–14

3 Nefi 27:19–21

- Si ndihesh rreth Jezu Krishtit dhe asaj që Ai ka bërë për të të përgatitur për ardhjen e Tij?